

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 864 Prot.

Tiranë, më 19.062017

VENDIM Nr. 112, datë 05.06.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.9, datë 05.06.2017, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit Hidroenergjitik të Devollit "Ndërtimi i Shtëpive zëvendësuese Maliq"*, të prekura nga ndërtimi i HEC Moglicë, Bashkia Maliq-subjekti "Devoll Hydropower" sh.a.. realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Skënder Ali,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit Hidroenergjitik të Devollit "Ndërtimi i Shtëpive zëvendësuese Maliq"*, të prekura nga ndërtimi i HEC Moglicë, Bashkia Maliq-subjekti "Devoll Hydropower" sh.a., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Skënder Ali.
2. Në rast se gjatë zbatimit të punimeve identifikohen gjetje arkeologjike, bazuar në nenin 48 të ligjit 9048, datë 7.4.2003 "Për Trashëgiminë kulturore" (i ndryshuar), subjekti zbatues duhet të ndërpresë menjëherë punimet dhe të njoftojë Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Korçë dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

